

VENDIM
Nr. 601, datë 31.8.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË NDËRTESES E TË MJEDISEVE ADMINISTRATIVE, NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË TE BASHKIA KORÇË, DHE KALIMIN NË PRONËSI TË NDËRTESES E TË MJEDISEVE ADMINISTRATIVE, NGA BASHKIA KORÇË TE KËSHILLI I QARKUT KORÇË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1223, DATË 3.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PRONËSI KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Këshilli i Qarkut Korçë te Bashkia Korçë, sipas formularit bashkëlidhur, për sistemimin e administratës me ambiente pune dhe revokimin e së drejtës së pronësisë për këtë pronë Këshillit të Qarkut Korçë.

2. Kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative nga Bashkia Korçë te Këshilli i Qarkut Korçë, sipas planimetrive bashkëlidhur, për sistemimin e administratës me ambiente pune dhe revokimin e së drejtës së pronësisë për këtë pronë Bashkisë Korçë.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 1223 datë 3.9.2008, të Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli i Qarkut Korçë, Bashkia Korçë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN DHE TRANSFERIMIN E AMBIENTEVE
ADMINISTRATIVE PRONËSI TË NJËSIVE VENDORE**

Këshilli i Qarkut Korçë


Nr.	Emri i pronës Adresa Pronari	Sip. totale e pasurisë m ²	Sip. totale truall m ²	Sip. totale ndërtësë m ²	Renditja e ambienteve brenda pronës	Lloji i pronës sipas përdorimit aktual	Institucion që ushtron autoritetin administrativ mbi ndërtesën	Kërkohet për transferim
1	Këshilli i Qarkut Korçë Bulevard "Republika" Korçë	4526	3400	1126		Zyrat e Këshillit të Qarkut	Këshilli i Qarkut	Inventarizim dhe transferim
2	Garazh i veçuar			72		Garazh	Këshilli i Qarkut	Inventarizim dhe transferim
3	Ndërtesë provizore			26.6		Ambiente gjelbërim	Këshilli i Qarkut	Inventarizim dhe transferim



PLANIMETRI



BASHKIA KORÇE
PLANIMETRIA E KATIT TE PARE



 REPUBLIKA E SHqipëRIE BASHKIA E KORÇE DREKTORIA E PLANIMETRIE KONTROLI E SHËRIMIT E TËRRESIA	SHKURTORI SHKURTORI	
	SHKURTORI SHKURTORI	
DATA E SHËRIMIT E SHËRIMIT SHËRIMI E SHËRIMIT E SHËRIMIT	SHËRIMI SHËRIMI	SHËRIMI SHËRIMI